



Decentralizimi dhe qeverisja vendore në Korçë

Konteksti i projektit

Projekti konsistoi në mbështetjen e njërive të qeverisjes vendore në qarkun e Korçës për të zhvilluar dhe zbatuar planin e zhvillimit ekonomik. Projekti përfshiu edhe asistencë për Ministrinë e Qeverisjes Vendore, për të zhvilluar aspektet dhe rregulloret ligjore për funksionet kryesore të qarqeve. Projekti u zhvillua në dy nivelet e qeverisjes dhe të gjithë sektoret e ekonomisë: familjare, komunitetin e biznesit dhe institucionet rajonale dhe të zhvillimit, që janë gjerësisht të përfshira në projekt. Projekti zhvillon brenda kuadrit ekzistues ligjor një politikë të re që lehtëson zhvillimin rajonal.

Fazat e Projektit

➤ Faza e parë e projektit përfshiu zhvillimin e pesë moduleve të cilët zgjaten gjashtë muaj secili.

Moduli i parë sqaroi se ku duhet të fokusohet projekti. Pas diskutimesh qartësimi me Këshillin Rajonal, Ministrinë e Qeverisë Vendore dhe Decentralizimit (MPVD) dhe me SIDA në Tiranë, u vendos që nga 34 qeveri vendore në nivelin e parë (komuna dhe bashki) në qark, nëntë komuna pilote u zgjodhen për mbështetje: Liqenas, Voskopoje, Proptisht, Hudenisht, Mollas, Bulgarec, Voskop, Proger, dhe Qender-Bilisht. Prioritetet e ndërhyrjes u hartuan në sajë të një procesi të gjatë me seminare, takime dhe konferenca, duke përfshirë qindra përfaqësues nga qeveritë vendore – të zgjedhurit lokal dhe ekspertë – dhe



kategori të tjera të aktorëve kryesorë në qark. Ky proces gjithëpërfshirës krijoi një bazë të fortë mbi të cilën u bazuan planifikimi i projektit dhe ngritje kapacitetesh në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar. Një analizë për funksionet u realizua në mënyrë që të shihej sesi Këshillat Rajonal ishin të organizuar dhe të trajnuar për të arritur qëllimet dhe objektivat të parashikuara në projekt. Bazuar në informacionin e grumbulluar nga aktivitetet e përmendura më lartë, gjatë projektit u hartuan planet e punës për modulet 2 – 5 që përshkruanin aktivitetet e nevojshme për të arritur qëllimet dhe objektivat e këtij projekti.

Fushat e Aktiviteteve

- Mbështetja e qeverisjes demokratike
- Planifikimi i zhvillimit me pjesëmarrje
- Zhvillimi i metodave dhe aftësive (duke u fokusuar në fushat e qeverisjes demokratike, manaxhimi financiar, planifikimi fizik dhe metodat e planifikimit për zhvillim).
- Rritja e kapaciteteve të Këshillit Rajonal

- Aktivitete në nivel kombëtar

Të gjitha manualët janë të disponueshme në zyrën e IKU-s.

FAKTET KRYESORE

PARTNERET:

- ✓ SIDA (Agjensia Ndërkombëtare Suedeze e Zhvillimit)/SIPU International (Suedi)

KOHËZGJATIA:

Tetor 2002 – Tetor 2005

PËRFITUESIT:

- ✓ Njesit vendore Korçë

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtoresh Ekzekutive

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë
Tel: +355 4 2256840
E-mail: uri@uri.org.al
Web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitet e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.